



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE  
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA  
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM  
Nr. 279, datë 24.06.2022

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS KANALIZIME  
KONISPOL SH.A.

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "*Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura*", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "*Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence*" (**VKM nr.958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29 datë 08.12.2009 "*Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura*", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

**Komisioni Kombëtar Rregullator,**

në mbledhjen e datës 24.06.2022 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e vendimit "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Konispol sh.a.",

**Vëren se:**

1. Ujësjellës Kanalizime Konispol me shkresën nr.54 prot., datë 11.05.2022 dhe plotësimet me shkresën nr.60 prot., datë 06.06.2022 ka paraqitur kërkesën pranë ERRU për rinovim licence të shoqërisë për kategorinë A të shërbimit - grumbullimi dhe shpërndarja e ujit për konsum publik, për efekt të mbarimit të afatit.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit të UK Konispol në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit.

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

- a) Shoqëria UK Konispol ofron shërbimin e furnizimit me ujë për 13 005 banorë të Bashkisë Konispol;
- b) Drejtuesi ligjor i shoqërisë z. Altier Xhaferri është diplomuar në Fakultetin e edukimit dhe shkencave shoqërore Dega Administrim Publik, në Universitetin “Eqerem Çabej” Gjirokastër në vitin 2009, si dhe Master shkencor “E Drejta Publike” në Universitetin Mesdhetar në vitin 2018;
- c) Drejtues teknik i shoqërisë z. Mikelo Taka është diplomuar në Bachelor në Inxhinieri Mekanike, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, në vitin 2014 dhe Master Profesional në Operacione Industriale dhe Navale në viti 2018.

4. ERRU në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Konispol , të:

- a) Kërkesave të ligjit nr. 8102 si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, efikasitetin, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;
- b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” të ndryshuar, (**ligji nr. 9121**) për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Konispol është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

#### **VENDOSI:**

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Konispol sh.a me (NUIS L74829801V), në kategoritë:
  - a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik
2. Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Konispol sh.a autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

- a) Drejtues Ligjor – Altier Xhaferri
  - b) Drejtues Teknik – Mikelo Taka
3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Konispol sh.a është Bashkia Konispol.
  4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 vjeçare.
  5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Konispol sh.a detyrohet të nënshkruajë Kushtet e Licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.
  6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Konispol sh.a për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Ndriçim Shani**